Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0813

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga, Isa Hasani-kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE Crazy Pet SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "SHËRBIME VETERINARE" me numër të prokurimit; 214-24-5514-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS, më, 24.10.2024, mori këtë:

Vendim

1.Refuzohet, si e pabazuar ankesa e OE "Crazy Pet" SH.P.K., me nr. 2024/0813, e datës,06.09.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit "SHËRBIME VETERINARE" me numër të prokurimit :214-24-5514-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS.

2. Vërtetohet "Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues" datës,20.08.2024, i AK-Policia e Kosovës, lidhur me aktivitetin e prokurimit "SHËRBIME VETERINARE" me numër të prokurimit; 214-24-5514-2-2-1.

3.Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 28.06.2024 POLICIA E KOSOVËS, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit "SHËRBIME VETERINARE" me numër të prokurimit 214-24-5514-2-2-1.

Me 20.08.2024 POLICIA E KOSOVËS, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin (B58), duke shpërblyer Grupin e Opertorëve Ekonomik Klinka Veterinare –Pet O.P ; Haki Bytyqi B.I.

Autoriteti kontraktor ka zbatuar: Procedurë të hapur, Lloji i kontratës: shërbim, Vlera e parashikuar e kontratës: 58,360.00 euro.

Me 24.08.2024, OE Crazy Pet SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar kërkesa për rishqyrtim me Vendimin e AK të datës 29.08.2024.

Me 06.09.2024, OE Crazy Pet SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2024/0813, duke e atakuar Njoftimin mbi vendimin.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Crazy Pet SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I)– Në këtë pretendime OE ankues pretendon se AK-ja ka shkelur nenin 1 - Qellimin te LPP-s ,pasi që pretendon se GOE-ve i rekomanduar me dhënie të kontrates ka ofruar cmime manipulative për pozicionet :

Poz.5 - Analizat e gjakut (biokimike dhe hematologjike)sipas nevojës – 5 Euro

Poz.12 - Largimi i tumoreve te ndryshëm me ane te intervenimit kirurgjikal si dhe terapija deri ne mjekim përfundimtar dhe anestezioni – 30 Euro

Poz.14 - Kollare kundër parazitëve (delta metri n 1 gram)45 cm- 65 cm 2 her ne vit - 10 Euro

Poz.22 - ID Elektronik (qipi) për qen zyrtar –dhe libreza e RKS – 1 Euro

Poz.23- Qethja e qenit – 2 Euro.

Pretendimi i dytë (II): Në ketë pretendime ankimore ,OE akues pretendon se AK-ja ka shkelur nenin e 59 te LPP-së pasi që ka rekomanduar që të shpërblehet me kontratë GOE-ve ti cilat nuk i kanë plotësuar të gjitha kërkesa e kërkuara nga vet AK-ja ,duke pretenduar se GOE-ve nuk ka plotesuar kriterin për kontratat e realizuara sipas kërkesën së nenit 69 , kërkesën : Kapaciteti teknik dhe profesionala) OE duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se njëjte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit jo me pak se 50,000.00 €.

Përgjigje ne kërkesën për rishqyrtim:

Autoriteti Kontraktues (AK) e kundërshton pretendimin se ka shkelur nenet e Ligjit të Prokurimit Publik (LPP). Në vijim paraqiten sqarime të detajuara:

1. Neni 1 – Qëllimi i LPP: AK sqaron se ka siguruar shfrytëzim efikas të fondeve publike, duke publikuar njoftimin për kontratë në mënyrë të hapur dhe pa diskriminim. Të gjithë zyrtarët kanë vepruar me integritet dhe transparencë.

2. Neni 7 – Barazia në Trajtim: AK ka trajtuar të gjithë ofertuesit në mënyrë të barabartë dhe të paanshme. Komisioni ka vlerësuar ofertat sipas kritereve të dosjes së tenderit, duke rekomanduar ofertën më të ulët që plotësonte të gjitha kriteret.
3. Neni 59 – Vlerësimi i Ofertave: AK sqaron se nuk ka shkelur këtë nen, pasi vlerësimi i ofertave është bërë në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara.
4. Neni 69 – Aftësia Teknike: AK thekson se Grupi i Operatorëve Ekonomik ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara. Të gjitha kontratat e dorëzuara janë të realizuara dhe përfshijnë vlera që tejkalojnë 50,000.00 €.
5. Referencat për Kontratat: AK ka paraqitur referenca që vërtetojnë përvojën dhe kapacitetin e Operatorëve Ekonomik të rekomanduar. Të gjitha kontratat janë përfunduar me sukses dhe në përputhje me kërkesat.
6. Pretendimi për Shkelje të Rregullores dhe Udhëzuesve: AK sqaron se pretendimet për shkelje të rregulloreve janë të pabazuara, pasi të gjitha kriteret janë respektuar dhe oferta e rekomanduar është cilësuar si përgjegjshme.

Përfundimisht, AK konsideron se të gjitha pretendimet e Operatorit Ekonomik "Crazy Pet" janë të pabazuara dhe se procesi i prokurimit është kryer në përputhje me ligjin dhe rregullat përkatëse.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me ketë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me ketë, me 27.09.2024, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit rekomandime të cilat përshkruhen si në vijim:

- Ankesa të aprovohet si e pa bazuar,
- AK lejohet të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit.

Paneli konstatoi paraprakisht se Raporti i ekspertizës i përmban elementet qenësore sikurse kërkohet me nenin 113, paragrafi 3 të LPP dhe i njëjti është pranuar nga të dyja palët, konform nenit 115 të LPP lidhur me nenin 20 të Rregullores së cituar. Ankuesi nuk është pajtuar me raportin e cituar përderisa AK është pajtuar me raportin e ekspertit. Krahas kësaj konstatohet se palët janë të informuara reciprokisht lidhur me shkresat kësaj lënde (nga platforma e prokurimit elektronik) në pajtim me paragrafin 2, të nenit 20 të kësaj Rregulloreje prandaj ka kushte që Paneli të vendosi në mënyrë meritore përkitazi me ankesën.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Crazy Pet SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0813:

Konstatimi i parë (I): Pa hyrë në ndonjë analizë të hollësishme të këtij pretendimi ankimor, bazuar në pikën 41.1 të nenit 41 të Rregullores për Prokurim Publik, ku koncepti i tenderëve jo-normalisht të ulët i referohet tenderëve që për Autoritetin Kontraktues, në shikim të parë, duken si jo të besueshëm nëse krahasohen me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat, dhe që kanë gjasa për një ndikim negativ në performancën e implementimit të kontratës. Nëse këto çmime për Autoritetin Kontraktues janë çmime të pranueshme, atëherë mbetet në përgjegjësinë e Autoritetit Kontraktues që kontrata të implementohet në harmoni me kushtet e kontraktuara.

Bazuar në pikën 41.1 të nenit 41 të Rregullores për Prokurim Publik, pretendimi ankimor është i pabazuar.

Konstatimi i dytë (II): Eksperti shqyrtues sqaron se, pas shqyrtimit të pretendimit ankimor dhe analizimit të fakteve dhe argumenteve, bazuar në Ligjin për Prokurim Publik, nenin 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, Autoriteti Kontraktues e ka vlerësuar në harmoni me nenin e lartpërmendur, pasi duke u thirrur në këto argumente:

- Lista e kontratave e dorëzuar plotëson kërkesën e Autoritetit Kontraktues dhe është mbi vlerën minimale të kërkuar, pasi që kontratat e realizuara, disa prej të cilave janë të njëjta dhe disa janë të ngjashme me natyrën e kërkuar, ashtu siç është kërkesa e Autoritetit Kontraktues e vendosur në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, si:

Trajtimi, kastrimi dhe sterilizimi i qenve endacak – vlerësohet se është e njëjtë me natyrën e aktivitetit kontraktues.

Dezinfektimi i hapësirave publike; Dezinfektimi, dezinsektimi dhe deratizimi në institucionet komunale – vlerësohet se janë të natyrës së ngjashme me natyrën e aktivitetit, pasi në parametrat dhe parashikimet e publikuara nga Autoriteti Kontraktues, këto pozita janë të ngjashme me ato të kërkuara në pozitat 1 dhe 2 të kësaj parashikimi të publikuar për këtë aktivitet nga AK - Policia e Kosovës.

Shërbimet veterinare për gjedhe dhe qen në Q.K. Dubravë – vlerësohet se është e njëjtë me natyrën e aktivitetit të prokurimit.

Po ashtu, kontrata "Shërbimet veterinare në terren - Lot 13, Komuna e Istogut", e cila është kontestimi thelbësor nga ana e OE ankues, vlerësohet se është e ngjashme me natyrën e aktivitetit, pasi edhe vet aktiviteti i publikuar nga Autoriteti Kontraktues - Policia e Kosovës mban titullin "Shërbime Veterinare". Vetëm për ilustrim, po e paraqes listën e kontratave të cilës ju kam referuar.

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor i lartpërmendur nga OE ankues është plotësisht i pabazuar

-Gjetjet e Panelit Shqyrtues-

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen

dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtuese i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE "Crazy Pet SH.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Raporti i ekspertit shqyrtues ka vlersuar se pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE "Crazy Pet" SH.P.K janë të pa bazuara.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë të pa bazuara, te paraqitura ndaj vendimit të autoritetit kontraktues, të dates 20.08.2024, lidhur me shperblimin me kontratë për aktivitetin e prokurimit. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pa bazuara. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhe trefuzohet si e pa e bazuar dhe mbet në fuqi vendimi i autoritetit kontraktues për aktivitet të prokurimit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar ,Njoftimin për Vendimin e Autoritetit Kontraktues, Policia e Kosovës, për të shperblyer me kontratë, GOE" Klinika Veterinare King-Pet.:O.P.;Haki Bytyqi B.I" për aktivitetit prokurimit"Sherbime Veterinare", me numër të prokurimit ; 214-24-5514-2-2-1.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në ketë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportet e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet vlersimet e ekspertit shqyrtues me rekomandim, të cilët kanë shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij me numër; 2024/0813 të datës 27.09.2024, se gjatë zhvillimit të kësaj procedurë të prokurimit, autoriteti kontraktues ka zbatuar dispozitat ligjore të LPP-së.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar ”Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj” lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e refuzimit të ankese të OE ankues“Crazy Pet” SH.P.K , të konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP, ndërsa mjetet të kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **POLICIA E KOSOVËS**
- OE - **"Crazy Pet" SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: